



PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova D.O.
Nr./No./Br. 03-1752/2025
Data/Date/Datum 13-10-25
PRISTINE-PRISTINE-PRISTINE

POSTA E KOSOVËS SH.A.

FILATELIA E POSTËS SË KOSOVËS SHPALL KONKURSIN GARUES

Për dizajne artistike të motiveve për pulla postare dhe blloqe filatelike për temat nga programi i rregullt vjetor për vitin 2026

1. Tema e emisionit: ***Sporti – Kampionati Botëror i Futbollit***

Përshkrimi: Paraqitja artistike e Kampionatit Botëror të Futbollit 2026 në forma artistike si pikturë, fotografi artistike, grafikë, etj.

Shpërblimet: vendi i parë për pullë postare €300, vendi i dytë për pullë postare €250, shpërblimi për bllok filatelik €350.

2. Tema e emisionit: ***70-vjetori i pullës “Evropa”***

Përshkrimi: Paraqitja artistike në pikturë, grafikë apo fotografi të shënimit të 70-vjetorit të pullës postare me emërtimin “Evropa”, e cila simbolikisht shënoi fillimin e unitetit evropian, me qëllim të forcimit të solidaritetit si një themel të paqes stabile.

Shpërblimet: vendi i parë për pullë postare €300, vendi i dytë për pullë postare €250, shpërblimi për bllok filatelik €350.

3. Tema e emisionit: ***Trashëgimia kulturore - “Objekti i ish Bankosit “dhe “Rruga Marin Barleti-Prizren”***

Përshkrimi: Paraqitja artistike e objektit të ish Bankosit në Pejë, si dhe të rrugës Marin Barleti në Prizren në forma artistike si pikturë, fotografi artistike, grafikë, etj.

Shpërblimet: vendi i parë për pullë postare €300, vendi i dytë për pullë postare €250.

4. Tema e emisionit: ***Monumente natyrore - Shpella e Radavcit***

Përshkrimi: Paraqitje artistike në pikturë, grafikë, apo fotografi të Shpellës së Radavcit.

Shpërblimet: vendi i parë për pullë postare €300, vendi i dytë për pullë postare €250.

5. Tema e emisionit: *Dëshmorët: Indrit Cara-Kavaja, Tahir Sinani, Bylbyl Breçani*

Përshkrimi: Paraqitja artistike e dëshmorëve në formë artistike si pikturë, fotografi artistike, grafikë, etj.

Shpërblimi: vendi i parë për pullë postare €300, vendi i dytë për pullë postare €250, vendi i tretë për pullë postare €200.

RREGULLAT E KONKURRIMIT:

1. Dizajnet artistike (vizatim, pikturë, grafikë, fotografi artistike) të bazuara në këto tema duhet të punohen në programe të specializuara për dizajn si Adobe Photoshop, Illustrator ose Corel Draw. Të njëjtat duhet të dorëzohen të shtypura për nevoja të vlerësimit të komisionit, si dhe në dosje (file) kompjuterike. Punimet me rezolucion më të ulët se **500 px**. (TIFF, JPG ose PDF) nuk pranohen.
2. Për shkaqe të konfidencialitetit dhe objektivitetit, emri i autorit të dizajnit nuk duhet të shënohet pranë motivit konkurrues, aty duhet të shënohet vetëm shifra konkurruese, ndërkaq shënimet për autorin duhet të jenë të mbyllura në pliko të veçantë brenda plikos me punime konkurruese.
3. Komisioni i Pullës Postare, gjatë përzgjedhjes së dizajneve, nuk do të ketë qasje në shënimet autoriale, por ka të drejtë të kërkojë verifikimin e origjinalitetit të dizajneve potencialisht të përzgjedhura.
4. Dizajnet konkurruese për këtë konkurs duhet të dorëzohen në zarfe të mbyllura, duke shënuar temën/emisionin për të cilin konkurroni dhe shifrën konkurruese.
5. Një autor mund të konkurrojë me numër të pacaktuar të punimeve apo shifrave konkurruese brenda një teme.
6. Përgjegjësinë për të drejtat autoriale e mbart autori i dizajnit (konkurruesi).
7. Bazuar në: LIGJIN Nr. 04/L-065 PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA, autori fitues me dizajne të huazuara duhet patjetër të posedojë autorizimin me shkrim ose me e-mail nga autori i veprës origjinale, të cilën mund t'ia bashkëngjitë punimeve konkurruese ose ta dërgojë të skanuar në e-mail adresën: filatelia@postakosoves.com dhe ta sjellë në "hard copy" në Zyrën e Filatelisë.

8. PK Sh.A. mban të drejtën e përdorimit të dizajnit në motive të pullave postare ZDP, VDP, si dhe në produkte filatelike të ndërlidhura me pulla postare dhe shërbim postar.
9. Vlera e shpërblimeve për dizajne fituese është paraqitur si vlerë bruto.

KONKURSI do të jetë i hapur 40 ditë kalendarikë, prej datës: 15.10.2025 deri më 23.11.2025 dhe do të jetë i publikuar në ueb faqen: www.postakosoves.com.

Punimet konkurruese nuk do t'iu kthehen autorëve.

Zgjedhjen e punimeve më të mira konkurruese, duke u bazuar në dizajnin më të mirë dhe ndarjen e shpërblimeve, do ta bëjë Komisioni i Pullës Postare.

Punimet konkurruese mund t'i dorëzoni në Arkivin Qendror të Postës së Kosovës, apo t'i dërgoni përmes letërdërgesave nga çdo zyrë postare në adresën:

Ndërtesa kryesore e Postës së Kosovës

Arkivi Qendror/ Për Konkurs-Filateli

Rr. "28 Nëntori" nr. 4, Dardani

10000 Prishtinë

Për informata shtesë mund të thërrisni në numrin e telefonit: **+383(0)38 246 770**, apo të drejtoheni në e-mail adresën: filatelia@postakosoves.com, ose në ueb faqen zyrtare: www.postakosoves.com